



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 4033 Prot.

Lezhë, më 7 / 4 /2023

RAPORT VJETOR PËR DËGJESAT PUBLIKE PËR VITIN 2022

Procesi i njoftimit dhe i konsultimit publik në Bashkinë Lezhë përgjatë vitit 2022, është bazuar në parimet e mëposhtme:

- a) Transparencë gjatë procesit të njoftimit dhe të konsultimit publik,
- b) Pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese,
- c) Efektshmëri e procesit të vendimmarrjes në organet publike,
- d) Përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara.

I gjithë procesi është realizuar në zbatim të Ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe konsultimin Publik”, Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Vendimin Nr.393 datë 18.07.2022 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë”.

Bashkia Lezhë dhe Këshilli Bashkiak kanë bashkëpunuar për realizimin e një procesi konsultimi efikas duke optimizuar burimet në dispozicion. Gjatë vitit 2022, janë realizuar 6 dëgjesa me banorë në qytetin e Lezhës dhe njërive administrative përkatëse. Ndërkohë, për konsultimet në kuadër të Buxhetit 2023, PBA 2023-2025 dhe Paketës Fiskale 2023 u realizuan në proces gjithsej 3 takime të dokumentuara me procesverbal të plotë, pasqyruar¹ edhe në platformën konsultimivendor.al, në të cilën Bashkia Lezhë ishte një ndër shtatë bashkitë pilot e përzgjedhur nga UNDP/STAR 3.

Gjatë vitit 2022, Bashkia Lezhë bashkëpunoi me Projektin STAR 3, nëpërmjet Qendrës për Cështje të Informimit Publik (INFOCIP), për të rritur vizibilitetin e procesit të Konsultimit Publik si dhe për konsolidimin e një modeli të avancuar që mund t’u shërbejë edhe bashkive të tjera të vendit. Të gjitha seancat konsultuese/dëgjesat janë pasqyruar në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Lezhë, në rrjetet sociale që ka në administrim Bashkia dhe Këshilli Bashkiak si dhe për herë të parë në platformën: www.konsultimivendor.al në faqen e posaçme dedikuar Bashkisë Lezhë brenda kësaj platforme(<https://konsultimivendor.al/bashkia-lezhe/>).

Ky raport vjetor është hartuar në zbatim të detyrimeve që cakton për autoritetin publik neni 20, i Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. *Sipas parashikimeve të këtij neni,*

¹ Shiko procesverbalet: <https://konsultimivendor.al/bashkia-lezhe-procesverbalet-e-konsultimeve/>



organet publike hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për:

- a) numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues;
- b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
- c) numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit;
- c) numrin e takimeve publike të organizuara.

➤ **Numri i akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit 2022.**

Këshilli Bashkiak Lezhë miratoi në total 141 vendime gjatë vitit 2022², të cilat gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë si edhe në platformën VENDIME.AL, në të cilën ato gjithashtu publikohen konform standartit të unifikuar të publikimit.

➤ **Numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara:**

Gjatë procesit konsultativ në lidhje me “Konsultimin Publik për Projekt Buxhetin Afatmesëm 2023-2025” faza përfundimtare, u regjistruan gjithsej 18 rekomandime konkrete.

➤ **Numri i takimeve publike të organizuara:**

1. Datë 11.02.2022 Bashkia Lezhë: Njoftim Publik/Anketim për cilësinë e shërbimit të pastrimit.³

Bashkia Lezhë ftoi më datë 11.02.2022 (data e njoftimit zyrtar në faqen e internetit) qytetarët për plotësimin e një anketimi online⁴ për cilësinë e shërbimit të pastrimit në territorin e kësaj bashkie. Nëpërmjet këtij anketimi qytetarët sugjeruan mendimet e tyre për mënyrat e ofrimit të shërbimit, ide për përmirësim, në funksion të një mjedisi më të pastër dhe cilësie jete më të lartë.

2. Data 10.06.2022 Konsultim me publikun i Projekt-Buxhetit Afatmesëm 2023-2025. Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për qeverisjen vendore”, neni 18, Ligjin Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe në Rregulloren për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Median, miratuar me VKB Nr.56 Date 28.04.2020, KB Lezhë miratoi planin e konsultimeve me publikun lidhur me projekt-aktin “Buxheti Afatmesëm i Bashkisë Lezhë 2023-2025”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, z. Pjerin Ndreu. Qëllimi i këtij konsultimi ishte për të mbledhur sugjerimet e komunitetit lidhur me:

1. Mënyrën si janë shpenzuar fondet për ofrimin e shërbimeve nga bashkia,
2. Performancën e shërbimeve të ofruara nga bashkia,
3. Shërbimet prioritare të komunitetit.

² Vendimet e Bashkisë Lezhë për Vitin 2022: <https://www.vendime.al/category/lezhe/2022-lezhe/> si dhe mund të hapen njëkohësisht direkt nga faqja zyrtare e Bashkisë Lezhë në këtë link: <https://lezha.gov.al/vendime-te-keshillit-2022/>

³ <https://konsultimivendor.al/anketim-per-cilesine-e-sherbimit-te-pastrimit/>

⁴ Linku i Anketimit: <https://www.surveymonkey.com/r/M3C9TFB>



Në lidhje me njoftimin publik të mësipërm, bazuar në njoftimin dhe kalendarin zyrtar të publikuar⁵ në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë dhe në platformën konsultimivendor.al u parashikuan 12 konsultime në total.

3. Datë 11.06.2022 / Bashkia Lezhe thirri takim konsultues per Planin të dytë social të Bashkisë Lezhë. Njoftimi për këtë takim konsultues u publikua në datën 11.06.2022 në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë. Takimi u zhvillua në datën 06.07.2022 pranë Pallatit të Kulturës në qytet. Ky takim u drejtua nga Drejtoria e Shërbimit Social, e cila konsultoi me grupet e interesit përgatitjen e planit të dytë social vendor 2022-2025, për adresimin e nevojave sociale të grupeve vulnerabël në territorin e Bashkisë Lezhë. Në takim moren pjesë rreth 30 banorë.

4. Date 22.06.2022 / INFO DAY “Hapja e thirrjes së IV-t të Programit Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin perëndimor (ReLOad)

Bashkia Lezhë në datën 22.06.2022 publikoi njoftimin zyrtar në faqen zyrtare në internet për organizimin e takimit të sipërcituar. Takimi u zhvillua në datën 22.06.2022, në orën 10:00, pranë Qendrës Kulturore të fëmijëve. Në takim morën pjesë Znj. Eueda Molla, Zv. Kryetare i Bashkisë Lezhë si dhe Z. Elson Frroku, Drejtor i Drejtorisë së Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës si dhe 28 përfaqësues të OSHC-ve. Axhenda e takimit konsistonte në një prezantim të shkurtër mbi zbatimin e Programin ReLOaD, informim mbi projektet e zbatuara në tre thirrjet e para publike si dhe prezantimi prioriteteve, afatet e përafërta të shpalljes së thirrjes së katërt, shumat në dispozicion dhe kohëzgjatja e zbatimit të projekteve. Në takim moren pjesë rreth 25 banorë.

5. Date 29.08.2022 / Konsultim i dokumentave për vlerësimin e ndikimit në mjedis për “Projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore Vorë-Hani i Hotit”

Bashkia e Lezhës ftoi për informim dhe konsultim publik këshilltarët, qytetarët, teknikienët dhe palët e interesuara në lidhje me VNM e “Projektit të zbatimit për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit, Shqipëri”, pjesë e korridorit të X-të, mbështetur nga Fondet e Bashkimit Evropian.

Me qëllim informimin dhe përfshirjen e aktorëve vendorë, në mënyrë që të arrihen zgjidhje të pranueshme për të gjitha palët e prekura, Bashkia beri publike paraprakisht të gjithë dokumentacionin e Projektit në faqen e vet zyrtare në kuadër të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Bashkia hapi diskutim dhe sugjerime me shkrim nga palët e interesuara mbi dokumentet si më poshtë vijojnë:

- 1.0.-WB16-ALB-TRA-01 Raporti i Vlerësimit VNM Korrik-2021 rish-Korrik-2022

⁵ Shiko kalendarin e dëgjësave publike për PBA 2023-2025 në Bashkinë Lezhë: <https://konsultimivendor.al/wp-content/uploads/2022/09/Kalendari-i-Konsultimeve-Publike-PBA-bashkia-Lezhe.pdf>



- 1.1.-WB16-ALB-TRA-01 Raporti i Vleresimit Shtojcat Korrik-2021 rish-Korrik-2022
- 2. WB16-ALB-TRA-01 Permbledhje-Jo-Teknike-e-VNMS Korrik-20221 rish-Korrik-2022
- 3.-WB16-ALB-TRA-01 Plan-Menaxhimi-dhe-Monitorimi Korrik-2021 rish-Korrik-2022 Alb
- 4.-WB16-ALB-TRA-01 Plani i Angazhimit me Palet e Interesit Korrik-2021 rish-Korrik-2022
- 5.-WB16-ALB-TRA-01 Kuadri i Marrjes se Tokes dhe Risistemimit Korrik-2021 rish-Korrik-2022 ALB
- 6.-WB16-ALB-TRA-01 Plan-Vepriimi-MjedisorSocial Korrik-2021 rish-Korrik-2022 ALB

6. Date 17.10.2022 / Konsultim Publik, Paketa Fiskale 2023 dhe PBA 2023-2025 (Asistuar nga INFOCIP/STAR 3).

Bashkia lezhe planizoi tre takime konsultative per diskutimin e Buxhetit 2023 dhe PBA 2023-2025. Plani i degjesave u hartua nga koordinatori per konsultimin publik dhe u afishua ne faqen zyrtare te Bashkise si dhe ne Platformen www.konsultimivendor.al⁶

25 Nëntor 2022 – Bashkia Lezhë zhvilloi dëgjese publike në kuadër të hartimit të Buxhetit 2023, PBA 2023-2025 dhe Paketës Fiskale me banorë të njësisë administrative Balldre, njësisë administrative Dajc, njësisë administrative Blinisht, Kallmet dhe Ungrej, pranë ambjentit Bar Restorant “Suli” në autostradë, me prezencën e panelit prej gjashtë anëtarësh; Zv.Kryetari i Bashkisë z.Ermal Pecaj, Zv.Kryetarja e Bashkisë znj.Eueda Molla, Kryetari i Këshillit Bashkiak Z.Ndue Luli, Administratori i njësisë administrative Balldre Z.Redon Gjeloshi, Administratori i njësisë administrative Kallmet z.Eraldo Marku, Administratorja e njësisë administrative Dajc znj.Majlinda Miloti. Problemet kryesore që qytetarët paraqitën në këtë konsultim ishin; degradimi i “Rrugës së Torovicës”, mosfunksionimi i ujësjellësit të “Mabës”, kushtet e urës lidhëse “Rraboshtë-Balldre” anësorja e së cilës është dëmtuar dhe rrezikon jetën e fëmijëve kur kalojnë, si dhe mungesa e energjisë elektrike në disa zona. Të gjitha problematikat u dokumentuan dhe Kryetari i Bashkisë u bëri me dije qytetarëve që për secilën do të ketë një zgjidhje por duke prioritarizuar në fillim ato më të rëndësishmet.

26 Tetor 2022 – Bashkia Lezhë zhvilloi konsultimin publik mbi hartimin te Buxhetit 2023 dhe Paketës Fiskale 2023 me banorë të njësisë administrative Shënkoll, Zejmen dhe Kolsh, pranë ambjenteve të Restorant “Orkidea” në orën 17:00. Takimi u drejtua nga Kryetari i Bashkisë Lezhe Z.Pjerin Ndreu bashkë me të në takim ishin gjithashtu të pranishëm Zv.Kryetarja e Bashkisë Znj.Eueda Molla, Kryetari i Këshillit të Bashkiak, Z.Ndue Luli, Administratori i Njësisë Administrative Shënkoll z.Ernest Rakaj, Administratori i njësisë Administrative Zejmen z.Gjergj Malshi dhe Administratori i njësisë administrative Kolsh Z.Fatjon Zefi.

⁶ Shiko planin e degjesave: <https://konsultimivendor.al/bashkia-lezhe-njoftimi-zyrtar-per-miratimin-e-kalendarit-te-konsultimeve-publike-per-taksat-dhe-tarifat-vendore-si-dhe-pba-ne-2023-2025/>



Në prezantimin e tij kryetari i bashkisë u bëri me dije qytetarëve që 60% e buxhetit për infrastrukturë do të shkojë për ndërhyje në zonat rurale, duke përfshirë ndricimin, investime në asfaltim rrugësh, trotuare, ujësjellës dhe shërbime të tjera sipas nevojave dhe kërkesave të komunitetit. *Ky takim u mbështet dhe u lehtësua nga Qendra për Cështjet e Informimit Publik (INFOCIP) dhe nga Drejtori i saj ekzekutiv z. Gerti Shella, në kuadër të projektit “Promoting Public Consultations and Participation at Local Level”, mbështetur nga STAR 3/UNDP.⁷*

22 Nëntor 2022 – Bashkia Lezhë zhvilloi konsultimin e fundit publik në kuadër të hartimit të buxhetit 2023, PBA 2023-2025 dhe paketës fiskale me banorë të njëjtit administrativ Shëngjin dhe Lezhe, i mbajtur pranë ambjenteve të Qendrës Kulturore të fëmijëve “Gjergj Lacaj”, me prezencën e Kryetarit të Bashkisë z. Pjerin Ndreu, zv. Kryetares së Bashkisë znj. Eueda Molla, Kryetarit të Këshillit Bashkiak z. Ndue Luli, dhe Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore z. Dritan Boci. Në këtë konsultim kryetari i bashkisë vuri theksin e diskutimit në disa investime të rëndësishme që janë në proces për t’u realizuar, konkretisht ish-in; trotuari i Ilgjes “Gjenio”, Rikualifikimi i Rrugës “Ishull-Shëngjin”, Lagjia e re “Ishull-shëngjin”, Byepassi i Shëngjinit, Rehabilitimi i Lulishtes së bregut të Drinit, pranë Memorialit, Ndërtimi i shkollës 9-vjecare “Gjergj Kastrioti”, Rikonstruksioni i Pallatit të kulturës dhe bibliotekës, Ura në lagjen “Skëndërbeg”, ndërtimi i së cilës do të ndikonte në eliminimin e trafikut, ndërtimi i pallatit në hyrje të qytetit me fondet e veta. *Ky takim u mbështet dhe u lehtësua nga Qendra për Cështjet e Informimit Publik (INFOCIP) dhe nga Drejtori i saj ekzekutiv z. Gerti Shella, në kuadër të projektit “Promoting Public Consultations and Participation at Local Level”, mbështetur nga STAR 3/UNDP.⁸*

DREJTORI

Elson Frroku

Gjystina Nik-ulaj

Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

⁷ Shiko takimin në foto dhe audio-video: <https://konsultimivendor.al/bashkia-lezhe-degjese-publike-ne-nj-a-zejmen-shenkoll-dhe-kolsh-per-paketen-fiskale-dhe-pba-2023-2025/>

⁸ Shiko takimin në foto dhe audio-video: <https://konsultimivendor.al/bashkia-lezhe-konsultim-publik-ne-nj-a-lezhe-dhe-nj-a-shengjin-per-paketen-fiskale-dhe-pba-2023-2025/>